



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
AGJENCIA E TRASHËGIMISË KULTURORE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË AUTOBUZËVE ELEKTRIK

Nr 7239 Prot

Gjirokastrë më 3/7 /2026

Lënda: Njoftim për transportin publik të vizitorëve vendas dhe të huaj në Bashkinë Gjirokastrë

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 8308, dt. 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (ndryshuar me ligjet nr. 8908, dt. 6.6.2002; nr. 9096, dt. 3.7.2003; nr. 9373, dt. 14.4.2005; nr. 9760, dt. 21.6.2007; nr. 10137, dt. 11.5.2009; nr. 10 302, dt. 15.7.2010; nr. 118, dt. 13.12.2012; nr. 21, dt. 14.2.2013; nr. 37, dt. 10.4.2014; nr. 10/2016, dt. 11.2.2016), Vendimit nr. 85, datë 8.2.2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor (ndryshuar me VKM nr. 224, datë 13.4.2022), Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 02.09.2025 me objekt “Plan Menaxhimi për Transportin Publik të Vizitorëve të Huaj dhe Vendas në Bashkinë Gjirokastrë”,

Ditën e Shtunë, datë 04.07.2026 do të fillojë të funksionojë itinerari i transportit publik për vizitorët e huaj dhe vendas si më poshtë;

Linja do të jetë; Lagjia “18 Shtatori” -Ura e Lumit-Postobllok-Sheshi “Çerçiz Topulli”- Baypass-Kala-Lagjia Palorto-Gërhoh-Parku Virua-Lagjia “18 Shtatori”

Orari për periudhën Mars-Tetor, nisja do të bëhet në orën 10;30 dhe shërbimi do të ofrohet deri në orën 23;00, itinerari do të bëhet çdo dy orë. Për periudhën Nëntor-Shkurt shërbimi i transportit do të ofrohet nga ora 10;30 deri në orën 22;30.

Duke ju faleminderuar për mirëkuptimin!

